

Lorena Berdún

Seksi ynë

Përktheu nga spanjishtja: **RABI LORA**

Titulli i origjinalit: *Nuestro sexo*

© 2004, Lorena Berdun

©

1. EVOLUIMI I GRUAS

Për fat të mirë, ditët e sotme, ne, gratë, e shohim seksualizmin në një këndvështrim krejt të ndryshëm nga ç'është parë përgjatë rrjedhës së historisë. Dhe ky element shumë i rëndësishëm i jetës sonë është zhvilluar hap pas hapi me evoluimin e qenies njerëzore.

Përgjatë shekujve, seksualizmi femëror është trajtuar në mënyrë të gabuar. Ne, gratë, duhej të ishim në shërbim të kërkesave të burrave dhe shpërfillej krejtësisht e drejta jonë për të ndjerë, për të zgjedhur e për të dëshiruar. Do të ishte feja çifute e para që do ta nënvlerësonte gruan dhe do ta konsideronte thjesht si një objekt seksual. Testamenti i Vjetër e bën më se të qartë që roli i femrës kufizohet te lindja e fëmijëve e kujdesi për ta, asgjë më shumë. Një gjë të tillë krishterimi e shtyu edhe më tej, duke bërë që shfaqja e seksualizmit të shihej si

mëkat i rëndë thuajse në të gjitha rastet. As që është e nevojshme të shpjegojmë si e trajton islamizmi këtë temë... Këto ligje dhe dhunimet e vazhdueshme zhdukun çdo mundësi që gruaja të shprehej si qenie me dëshira seksuale.

Por me fillimin e shekullit XX nisi një lëvizje femërore për çlirim, që është shtrirë deri ditët e sotme dhe që po i ofron gruas rol gjithnjë në ngritje në gjithçka që përfshin seksualizmi. Falë revolucionit që mori jetë gjatë viteve gjashtëdhjetë (që nuk i çliroi gratë, por i vuri në rrugë të mbarë), seksualizmi u është nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme. Sa për të filluar; përdorimi i pilulës kontrceptive do të thoshte për gruan mundësi për të zgjedhur me dëshirën e saj çastin e duhur për të mbetur shtatzënë. Në atë kohë, të lindje një fëmijë pa qenë e martuar ishte diçka e papranueshme, gjë që ndodh edhe sot, dhe mundësia e përdorimit të mjeteve parandaluese ishte një hap i madh përpara. Gama e formave dhe mjeteve kontrceptive është shumë e gjerë. Duke ditur se “marrëdhënie seksuale” nuk përkthehet detyrimisht amësi, kemi fituar një liri të madhe që na ka ofruar mundësinë të kryejmë marrëdhënie seksuale kur të duam e me kë të duam dhe njëherësh t’i lindim fëmijët kur dëshirojmë ne që të lindin. Ky detaj i parëndësishëm në dukje, siç është mundësia e programimit të shtatzënisë, ka bërë që roli ynë në shoqëri të ndërrojë krejtësisht dhe të mos shihemi më si qenie thjesht riprodhuese. Tashmë në

marrëdhëniet në çift mund ta ndërthurim këtë funksion biologjik me atë të së dashurës pa prekur vlerat tona si gra.

Më në fund mund të shprehemi se jemi zotëruese të trupit tonë. Një arritje e tillë ka sjellë një ndryshim shoqëror aq të thellë, sa ekspertët ende nuk kanë arritur ta vlerësojnë në masën e duhur.

Por nuk mund të gënjehemi e të mendojmë se femrat e kanë shndërruar tërësisht qëndrimin dhe mënyrën e të përjetuarit të seksualizmit të tyre, pasi ende gjenden grupe jo të papërfillshme grash që nuk janë të afta ta konsiderojnë veten si qenie me nevoja e dëshira seksuale po aq të natyrshme sa edhe të meshkujve. Gjenden gra që nuk arrijnë ta vlerësojnë si duhet trupin e tyre, gra që mendojnë se organet gjenitale janë diçka e turpshme dhe e pistë, gra që nuk arrijnë ta përjetojnë seksualizmin në mënyrën e duhur për shkak të ndjenjave të tmerrshme të fajit që i mbysin sa herë bëhet fjalë për të bërë dashuri. Siç duhet të ndodhë edhe natyrshëm, zhvillimi i kulturës, shoqërisë dhe i jetës moderne po i ndryshojnë këto mënyra jetese e të menduari, por ende mbetet shumë për t'u bërë.

Ajo që duhet parë vërtet si e rëndësishme është që gruaja nuk shihet më si një "objekt" seksual, por si pjesë vepruese në një lidhje. Kur një çift vendos në mënyrë të dyanshme të kryejë marrëdhënie seksuale, kjo duhet të ndodhë me bindjen e plotë të të dyve që në këtë marrëdhënie gjenden në kushte të barabarta. Ose, e thënë më qartë, një femër nuk duhet të ndihet inferiore dhe as të mendojë se partneri

i saj duhet të jetë detyrimisht aktori më i rëndësishëm, nismëtari i përhershëm... Po kështu, një mashkull nuk duhet ta paragjykojë një femër, pasi ka qenë ajo e cila e ka hedhur hapin e parë. Të gjithë e dimë se një grua quhet “e lehtë” apo “e papërmbajtshme” kur shpreh dëshirat në të njëjtën mënyrë si meshkujt. Gruaja duhet të tregojë siguri në vetvete dhe nuk duhet të lejojë që të bëhet pre e fyerjeve dhe e paragjytimeve të këtij lloji, të cilat duhet t’ia lëmë së shkuarës. Të ndryshosh këtë lloj mendësie nuk është aspak e lehtë, por është parë qartë se mund të arrihet duke luftuar e duke u përpjekur. Jo më kot, ditët e sotme, shumë femra i kanë kthyer këto paragjytime në armë. “Po, më pëlqen seksi po aq sa edhe ty. Ka ndonjë problem?” do të ishte një ndër frazat e parapëlqyera nga gratë moderne, të cilat kërkojnë me forcë të drejtën e tyre për të shfaqur të njëjtat dëshira dhe qëndrime seksuale që shfaqen edhe nga burrat.

Për ta arritur këtë, lipset të jetë tërësisht e qartë se të drejtat, qoftë të burrave, qoftë të grave, duhet të jenë të barabarta. Dhe një gjë të tillë duhet ta bëjnë prindërit gjatë edukimit të fëmijëve. Një fëmijë mund të luajë me kukulla dhe deri në njëfarë moshe, kjo nuk përbën asnjë problem. Ndasitë nisin të shfaqen më pas. Përse u mësohet djemve të jenë të ashpër e vajzave të jenë të brishta? Përse u thuhet djemve që burrat nuk qajnë? Shtangemi nga një burrë që i shpreh ndjenjat përmes lotëve, çuditemi se si mund të jetë kaq i ndjeshëm. Njëkohësisht nuk arrijmë të pranojmë se një grua e bukur mund të

jetë edhe e zgjuar. Na duket sikur këto gjëra nuk gjejnë asnjë pikëtakimi me njëra-tjetrën... Jashtëzakonisht shumë paragjykime rreth tipareve që duhet të karakterizojnë burrin e gruan.

Rolet për të dy sekset po ndryshojnë me shpejtësi, sidomos tani që gruaja profesioniste ka nevojë gjithnjë e më shumë për ndihmën e bashkëshortit në shtëpi. Rritja e fëmijëve duhet të bëhet nga të dy. Përse të mos fillojmë që këtu, nga rritja dhe edukimi i fëmijëve? Mendo që ti, ashtu si bashkëshorti yt, je e aftë të përballësh me çdo lloj vështirësie; që të dy duhet të jeni po aq të përgjegjshëm kundrejt seksualizmit të njëri-tjetrit; që duhet të merrni vendime të përbashkëta. Që kjo të ndodhë, duhet ta njihni mirë veten. Në të kundërt, do të ishte e pamundur të arrinit një nivel të kënaqshëm dhe të dyanshëm komunikimi.

Përmes këtij libri të ftoj ta njohësh pak më shumë seksualizmin tënd, seksualizmin tonë, një temë që ka zënë dhe zë një vend tejet të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme.

Ne dhe ata: ç'gjëra na bashkojnë dhe ç'na ndajnë

Organet gjenitale të një embrioni janë të njëjta gjatë muajve të parë të shtatzënisë, aq sa foshnja e ardhshme mund të jetë djalë po aq sa mund të jetë edhe vajzë. Në zanafillë zhvillimi i organeve seksuale është femëror. Ajo që e bën embrionin të jetë mashkull është se në një

çast të caktuar, fetusi nis të sekretojë testosteron, hormonin bazë mashkullor. Ky shndërrim fillon që në javën e shtatë të shtatzënisë; pikërisht në këtë çast nisin të krijohen testikujt. Tuberkuli gjenital ia lë vendin penisit. Zhvillimi i organeve femërore është pak më i ngadaltë dhe kryhet rreth javës së dhjetë të shtatzënisë.

Organet seksuale mashkullore dhe femërore janë shumë të përafërta: vërehet një ngjashmëri e qartë mes klitorit e penisit, vezoreve e testikujve, apo buzëve të mëdha e të vogla dhe qeseve të testikujve. Këto ngjashmëri morfologjike tregojnë se në të dyja rastet prirjet seksuale janë shumë të përafërta dhe se ndryshimet mes burrit e gruas, janë të natyrës fizike. Por sidomos të natyrës psikologjike, duke parë që proceset neuronale janë të ndryshme dhe varen nga përkatësia seksuale.

Le të themi se që nga fillimi i formimit si qenie njerëzore jemi të njëjtë, deri në çastin kur nisin të shfaqen ndryshimet. Seksi është fjala që përshkruan ndryshimin më themelor të gjinive tona; burra e gra. Pra, në vend që të flitet për seks fizik e të prekshëm, që më shumë përfaqëson organet tona seksuale, e mira është që seksualizmi të shihet si shfaqja e impulseve tona më intime.

Burra e gra, të cilët, duke qenë të nisur nga një gjenezë kaq e ngjashme, janë larguar mijëra vite drite përgjatë historisë për arsye krejtësisht sociale apo kulturore, tashmë janë në kërkim të pikave të përbashkëta për sa i përket seksualizmit. Por, përpara se të hyjmë në

hollësira për të dyja gjinitë, të shohim cili është reagimi i përbashkët seksual i burrit dhe gruas. Ose, e thënë ndryshe, si vepron organizmi i secilit kur nis stimulimi seksual. Ky reagim është shumë i përafërt për të dyja sekset, megjithëse secili prej tyre e arrin në mënyrë të ndryshme kulmin e kënaqësisë.

Janë disa reagime bazë që vihen re në të gjitha rastet:

1. Vërshim ose rritje e fluksit të gjakut. Falë ngacimit seksual, enët e qarkullimit të gjakut, në veçanti ato që u përkasin zonave gjenitale, mbushen me gjak. Siç edhe dihet, penisi ngrihet, sepse mbushet me gjak. E njëjta gjë ndodh edhe me klitorin dhe vulvën.
2. Tensioni muskolor, i cili shkaktohet drejtpërdrejt nga ngacimi seksual.

Duke i pasur parasysh këto, do të vërejmë se mashkullit i duhet shumë më pak kohë për ta arritur këtë gjendje, si dhe shkarkimin e gjithë tensionit seksual që ka grumbulluar, ose, e thënë ndryshe, në arritjen e orgazmës (sigurisht, kjo është e ndryshme te çdo njeri).

Le të shohim cilat janë fazat nëpër të cilat kalojnë meshkujt dhe femrat për të arritur orgazmën:

- *Faza e dëshirës*

Është vështirë të mendohet se mund të ketë një marrëdhënie seksuale pa një shkëndijë dëshire. Së jashtmi, në trup, mund të mos vihen re ndryshime të dukshme, por, siç mund të merret me mend, ndryshimet më të rëndësishme ndodhin në nivel psikologjik. Kur të pëlqen dikush, menjëherë nisin të shfaqen një seri shenjash që tregojnë praninë e kësaj dëshire.

- *Faza e eksitimit*

Penisi i burrit erektohet falë vërshimit të gjakut që mbush enët e tij. Edhe testikujt të zmadhohen, gjithashtu. Në rastin tonë shtohet sekrecioni vaginal, hyrja e vagjinës zgjerohet dhe buzët e saj fryhen për shkak të shtimit të fluksit të gjakut. Klitori del mbi “kapuç”, për shkak të ereksionit, disa grave u forcohen edhe thithat.

- *Faza e penetrimit*

Të gjitha ndryshimet që i përmendëm më lart theksohen. Në rastin e gruas zvogëlohet pak hyrja e vagjinës dhe buzët e mëdha fryhen. Kështu, arrihet një ngjeshje më e madhe rreth penisit.

- *Faza e orgazmës*

Është faza më e shkurtër. Në rastin e djemve ka dy çaste të rëndësishme, që duhen pasur parasysh:

1. Çasti “pa kthim pas”. Ose, thënë ndryshe, çasti kur, falë kontraktimeve që krijohen në organe të caktuara, sperma del nga uretri dhe bëhet e pamundur ndalja e ejakulimit.
2. Uretri dhe penisi vazhdojnë të kontraktohen deri në çastin e derdhjes së plotë të spermës.

Meshkujt duhet të mësojnë të dallojnë afrimin e pikës “pa kthim pas”, pasi kjo i ndihmon të presin dhe të mos ejakulojnë para kohe. Që kjo të mos ndodhë, është shumë e rëndësishme që ata të ruajnë kontrollin gjatë një marrëdhënieje seksuale, të mos jenë tepër të nxituar apo të shpërqendruar. Nëse mungon përqendrimi dhe nuk arrihet të kuptohet mbërritja e orgazmës, kjo nuk do të kryhet në çastin e duhur.